

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 27.04.2023

Kryesuesi i mbledhjes është Kryetari i Këshillit Bashkiak: z. Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 23

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh:23

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: 2

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një ndryshim në rendin e ditës , pika 15 kalon në pika 16. Gjithsej bëhen 18 pika.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 2 e rendit të ditës**

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 30- MARS 2023 .(me e-mail).

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka? Nga sekretaria ka pasur ndonjë problem?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 3 e rendit të ditës**

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 MARS 2023.

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.**

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social, Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK. Për periudhën Mars janë 58 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet romë dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Për muajin Mars 2023, është në dispozicion fondi prej 263.880 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike , nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond, përfitojnë 58 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 198.369 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 28 familje, në shumën 34.468 lekë. Pagesa totalë nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 233.137 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor ,sipas kriterëve specifike të miratuara 17 familje, me fond prej 61.935 lekë. Bazuar në Vendimet e mësipërme, përfituesit e kësaj kategorie, përzgjidhen kryesisht nga familjet e evidentuara nga administratorët socialë në nevojë ekstreme ekonomike dhe në kushte specifike sociale, pavarësisht cilësimit të sistemit elektronik të përzgjedhjes.

Persona të vetmuar 11

Persona në pamundësi fizike për të punuar 2

Kryefamiljare femra me fëmijë të mitur në ngarkim 2

Familje të komunitetit rom-egjiptian, me probleme dokumentacioni 2

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË".

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)** znj Irena Nikaj, znj.Gerla Koleci, znj.Maria Dojçe, znj. Silvi Tare, znj.Etleva Tare, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Joan Deli.

Këshilltare I.Nikaj: Atëhere sipas përcaktimeve ligjore është një procedurë që ne e kemi ndjekur në të gjitha rastet që kanë ardhur kërkesa që i plotësojnë ato kushtet për të përfituar nga programi social i strehimit mbështetje financiare e interesave të kredisë, ka ardhur propozimi për 7 familje të cilat përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë" bashkë me listën përkatëse, me kushtet që i përfitojnë këto lehtësime financiare. I propozoj këshillit bashkiak miratimin e këtij material.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

"PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA".

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)** znj Irena Nikaj, znj.Gerla Koleci, znj.Maria Dojçe, znj. Silvi Tare, znj.Etleva Tare, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Joan Deli.

Këshilltare I.Nikaj: Është një propozim për dy familjet aplikante, nënkuptohet për shkak të plotësisimit të dokumentacionit vijnë material të vecanta dhe është shumë pozitive që propozohet për tu lehtësuar mbështetja financiare për familjet e pastreha. Ftoj këshillin bashkiak ta miratojë këtë material të përpiluar nga ekzekutivi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 6 e rendit të ditës**

" PËR RISHPËRNDARJEN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA "

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)** znj Irena Nikaj, znj.Gerla Koleci, znj.Maria Dojçe, znj. Silvi Tare, znj.Etleva Tare, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Joan Deli.

Këshilltare I.Nikaj: Është një material për rishpërndarjen e banesave sociale me qira, është përcaktuar që një banesë sociale pranë bashkisë Korçë më nr. Pronësie 1/769 me 3+1 në ZK 8561 me qiramarrës një familje të miratojë dakordësinë e palëve për tu trajtuar secili më vetë mbi bazën e programit të banesave sociale me qira dhe ta autorizojë bashkinë Korçë për rishpërndarjen e banesës sociale me qira për familjen e një kryefamiljari që është vënë këtu në relacion. Është një procedurë që ne e kemi ndjekur. I propozoj këshillit bashkiak për ta miratuar një relacion të tillë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 7 e rendit të ditës**

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.180 DATË 28.12.2022 DHE TË VKB NR.11 DATË 20.01.2023 "PËR MIRATIMIN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE".

**(Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes)** z.Ervin Rota, z.Joan Deli, znj.Edlira Mitre, znj.Danjela Nasto, znj.Majlinda Duni dhe **(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare )** z. Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Këshilltare E.Mitre: Komisioni e shikon të arsyeshme që të miratohet ky relacion sepse duhen zëvendësuar nxënësit e larguar nga arsimit parauniversitar për shkak të mos frekuentimit. Mendoj që ta miratojmë këtë material. Do të zëvendësohen me nxënës të tjerë të cilët vazhdojnë të frekuentojnë.

Kryetari i këshillit bashkiak E.Nexhipi: Sa nxënës janë?

Këshilltare E.Mitre: 9 nxënës.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 8 e rendit të ditës**

**RAPORT I KONSOLIDUAR PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2022 .**

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Ekezkutivi V.Ziko: Raporti i konsoliduar i veprimtarisë ekonomiko-financiare i bashkisë Korçë për vitin 2022 është përgatitur duke iu referuar ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” Ky raport përmban një informacion financiar i cili është i paraqitur në këtë material dhe është i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor si dhe me vitin paraardhës. Raporti i konsoliduar për vitin 2022 është me vlerën 2,138,790 lekë, ndërsa realizimi është me vlerën 1,607,320 lekë ose 75%. Raporti i konsoliduar paraqitet sipas burimeve të financimit, sipas artikujve buxhetorë, sipas institucioneve dhe sipas programeve buxhetore . Duke iu referuar burimeve të financimit për vitin 2022 kanë qënë të ardhurat e trashëguara nga viti 2021, transfertat e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale si dhe ka patur sponsorizime dhe grante nga AZHBR dhe Ministria e shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes. Peshën specifike që kanë zënë për vitin 2022 këto burime janë të ardhura të trashëguara në masën 11%, transfertat e pakushtëzuar në masën 26%, të pakushtëzuar sektoriale 19%, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore 42% dhe 2% zenë grantet nga AZHBR dhe ministria. Ndërsa nëse do i referohemi përsëri sipas burimeve të disponueshme totali i burimeve për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 ka një rritje prej 8%. Gjithashtu në raportin e konsoliduar paraqiten edhe realizimi i shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë, ku duke ju referuar shpenzimeve të personelit realizimi është me vlerën 691,405 lekë , kundrejt planit është 741,669 lekë ose me masën 93%. Referenca është gjithmonë në krahasim me vitin 2021, ka një rritje prej 6%. Dhe peshën specifike që e zenë shpenzimet e personelit në lidhje me pagën e buxhetit janë 43%. Ndërsa në shpenzimet korrente ku përfshihen shpenzimet operative, subvencioni, transfertat nga organizata, transfertat nga individët, në shpenzimet korrente duhet të theksojmë që këtu përfshihen dhe të gjitha ato shërbime publike të cilat vecantërisht kryhen nga ndërmarja e shërbimeve publike dhe shërbimi i pastrimit që ze një peshë goxha të konsiderueshme. Realizimi i shpenzimeve korrente është me vlerën 725,690 lekë kundrejt planit me vlerën 935,477 lekë dhe realizimi është në masën 78%, ndërsa rritja e shpenzimeve në krahasim me vitin 2021 është në masën 7% dhe peshën specifike të tyre nga totali i buxhetit është 45%. Shpenzimet për principalin e interesit, pra bëhet fjalë për

kredinë që ka marrë bashkia është shlyer përfundimisht, ndërsa 2 kreditë e tjera Intesa San Paolo dhe kredia tjetër. Blerja e kredisë së parë është në vitin 2025 dhe e kredisë së dytë në vitin 2027. Realizimi i tyre është në masën 96% dhe zenë peshën specifike është 3% nga totali i buxhetit, e fundit është shpenzimet për investimet, shpenzimet kapitale, realizimi i tyre është me vlerën 144,367 lekë kundrejt planit 460,474 lekë, % e realizimit është në masën 37% dhe pesha specifike që ze nga totali i buxhetit është 9%. Shpenzimet në raportin e konsoliduar paraqiten njëkohësisht edhe sipas institucioneve ku përfshihen bashkia, ndërmarrja e shërbimeve publike, ndërmarrja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe cerdhes, qendra e artit dhe kulturës, klube shumë sportesh dhe 3 institucionet shtëpia e foshnjës, qendra rezidenciale e zhvillimit dhe qendra ditore. Realizimi i buxhetit të bashkisë për vitin 2022 ka qënë me vlerën 635,134 lekë kundrejt planit 1,051,477 lekë pra realizimi është në masën 60% dhe në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej rreth 10%. Ndërmarrja e shërbimeve publike ka një realizim prej 87% në vlerë është 441,631 lekë kundrejt planit 505,683 lekë dhe realizimi në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 5%. Ndërmarrja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe cerdhes realizimi është me vlerën 412,557 lekë kundrejt planit me vlerën 438,819 lekë, realizimi është në masën 94% dhe në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 8%. Qendra e artit dhe kulturës buxheti është realizuar në vlerën 74,513 lekë kundrejt planit 87,986 lekë dhe rritja për vitin 2022 në krahasim me 2021 është në masën 14%. Për klube shumë sportesh është realizimi i buxhetit është me vlerën 40,720 lekë, kundrejt planit 48,549 lekë, realizimi është 84% dhe në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 5%. Pra pak a shumë këto janë institucionet ku paraqitet realizimi i buxhetit, ndërkohë realizimi i buxhetit paraqitet edhe sipas programeve buxhetore të cilat bashkia për vitin 2022 i menaxhon në 27 programe buxhetore dhe % më të lartë të realizimit të programeve buxhetore është programi i shërbimeve publike në masën 89%, programi I arsimit bazë parashkollor në masën 94% , programi i kujdesit social për persona me aftësi të kufizuar në masën 95% dhe programi pagesa e shërbimit të borxhit në masën 96%. Pjesë e rëndësishme e raportit të konsoliduar janë dhe projektet të cilat për vitin 2022 u planifikuan me vlerën 16,558,000 lekë dhe realizimi i tyre është me vlerën 11,344,000 lekë, ku të gjitha projektet janë të paraqitura në material. Pjesë e rëndësishme e raportit të konsoliduar është dhe detyrimet e prapambetura. Në lidhje me detyrimet e prapambetura bashkia tregon situatën në të cilën ndodhet bashkia ku në rast se koeficienti i cili del nga raporti i detyrimeve të prapambetura me buxhetin në total të bashkisë është më i vogël se 15% tregon për një situatë normale të bashkisë dhe ndërkohë për vitin 2022 ky koeficient ishte me vlerën 0,01 pra tregon një situatë shumë të mirë të bashkisë Korçë. Pjesë përbërëse e raportit të konsoliduar janë dhe investimet ku unë do të theksoja investimet më të rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2022 të cilat kanë qënë edhe me bashkë financim nga buxheti i shtetit. Një nga investimet e cila është e financuar edhe nga ministria e mbrojtjes është ndërhyrja për shmangien e përmytjeve nga erozioni. Financimi nga buxheti i shtetit, nga Ministria e Mbrojtjes ka qënë më vlerën 55,188,232 lekë dhe 10% e vlerës së projektit do të financohej nga bashkia. Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit vlera dhe realizimi, flasim për realizimin dhe likuidimin total të këtij investimi është me vlerën 41,257,208 lekë. Një investim tjetër i bashkisë është edhe rikonstruksioni i shkollës Themistokli Gërmenji ku financimi, procedura e prokurimit është kryer në vitin 2022 dhe financimi I saj është njëkohësisht me 2 vite buxhetore, në vitin 2022 dhe 2023, ku financimi është kryer dhe nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë me vlerën 29,691,760 lekë ndërsa financimi nga buxheti i bashkisë është 18,891,418 lekë, ndërsa për vitin 2023 financimi nga ministria është 26,982,493 lekë ku investimet vazhdojnë aktualisht edhe në këto momente që po flasim. Një investim tjetër i rëndësishëm i cili është më bashkë financim përsëri nga buxheti i shtetit dhe nga Ministria e

Financave dhe Ekonomisë është përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra. Gjatë vitit 2022 nga buxheti i shtetit financimi ka qënë me vlerën 6,590,000 lekë për të cilën ky buxhet është realizuar, ndërsa për bashkinë Korçë ka qënë me vlerën 4,208,492 lekë, pra ky ka qënë kontributi i bashkisë për dy vite buxhetor, ndërsa financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2023 është me vlerën 1,224,838 lekë. Financime të tjera nga buxheti i shtetit kanë qënë nga AZHBR, është tregu i gjësë së gjallë ku investimi është realizuar dhe likujduar njëkohësisht me vlerën 22,642,704 lekë . Gjithashtu ministria e shtetit për mbrojtjen dhe sipërmarrjen është investimi për Start Up-et projekti qendra e inovacionit dhe kreativitetit multifunksional ku financimi nga buxheti i shtetit ka qënë me vlerën 19,999,008 lekë i cili është likujduar, ndërsa kontributi i bashkisë ka qënë me vlerën 9,729,019 lekë. Në të njëjtën kohë buxheti i bashkisë ka pasur financim përsëri nga ministria e mbrojtjes për mbrojtjen civile me vlerën 25,321,378 lekë i cili është përdorur për përballimin e situatave të vështira, shpenzime karburanti me vlerën 7,800,000 lekë, blerje pajisje profesionale për punonjësit e MZSH me vlerën 4,500 mijë lekë , blerja e uniformave profesionale për punonjësit e sektorit të pyjores me vlerën 2,900 mijë lekë shpenzime për blerje kripe 4,300 mijë lekë, rehabilitimi i rrugës auto pyjore Voskopojë Shën Kostandin me vlerën 3,000 mijë lekë , ndertim i pritave malore ne fshatin Nevecisht 2,600 mijë lekë. Pra kjo është pak a shumë raporti i konsoliduar me detaje më të rëndësishme që janë paraqitur në material.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka dicka? Komisioni?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 9 e rendit të ditës**

"PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.181 DATË 28.12.2022 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2023"".

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra së bashku me pikën 10 pra materiali "PËR RIALOKIMIN E FONDEVE PËR PËRBALLIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE PAS ZBATIMIT TË V.K.M NR.113 DATË 01.03.2023 të dyja pikat na i shpjegon ekzekutivi.

Ekzekutivi V.Ziko: Sipas VKM nr. 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” është përcaktuar se paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi është 40,000 (dyzet mijë) lekë. Është parë e nevojshme rillogaritje për pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjitha institucionet për bashkinë dhe institucionet vartëse. Dhe në këtë kuadër meqënëse këshilli bashkiak është kompetencë për miratimin e nivelit të pagave kërkohet

miratimi i pagës dhe njëkohësisht dhe të efekteve financiare. Efekti në total, efekti financiar sipas programeve dhe njëkohësisht sipas funksioneve. Në total efektet financiare për pagat dhe sigurimet shoqërore janë me vlerën 35,242,011 ku shpenzimet për pagat janë me vlerën 30,000,000 lekë dhe për sigurimet shoqërore 5,000,000 lekë. Ky efekt financiar mbas llogaritjeve që janë bërë nga ekzekutivi do të përballohen me vlerën 24,219,011 nga buxheti i bashkisë i miratuar për vitin 2023 brënda zërave të shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe 11,023,000 do të përballohen duke pakësuar shpenzimet operative dhe zërat të cilat janë të detajuara në material nga fondi të kursyera nga procedurat të prokurimeve që është realizuar si nga bashkia dhe nga institucionet e varësisë. Këto efektet financiare janë të llogaritura gjithsej 645 punonjës dhe konkretisht për bashkinë janë llogaritur për 74 punonjës dhe efekti financiar është me vlerën 3,141,500 lekë nga të cilat 3,116,500 do të përballojë fondi i planifikuar i shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe 25,000 lekë nga fondet e kursyera nga shpenzimet operative, nga prokurimet e zhvilluara për shpenzimet për materialet shpenzime printime dhe publikimi. Për ndërmarrjen e shërbimeve publike efektet financiare janë llogaritur për 345 punonjës, theksojmë që efektet financiare janë vetëm për pagën minimale dhe jo për asnjë nivel page tjetër të cilën do ta sqaroj pak më vonë efektet financiare janë me vlerën 18,163,109 lekë ku nga këto 10,827,000 do të përballohen nga fondi i shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore të institucionit të detajuara sipas programeve dhe funksioneve dhe 7,336,000 lekë do të përballohen nga fondet e kursyera nga procedura e prokurimit për asfalte dhe betone që ka zhvilluar ky institucion. Nga qëndra e artit dhe kulturës është për 21 punonjës efekti i rritjes së pagës minimale është 1,175,402 lekë, e detajuar sipas tabelës së mësipërme. Ky efekt do të përballohet nga fondi i planifikuar i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore në buxhetin e vitit 2023. Klubi Shumësportësh efekti është për 7 punonjës, efekti i rritjes së pagës minimale është 432,000 lekë. Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes efekti financiar është llogaritur për 198 punonjës është me vlerën 12,330,000 nga të cilat 9,100,000 lekë nga fondi i planifikuar për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore në produktet dhe 3,230,000 lekë do të përballohet nga fondet e lira pas prokurimeve në këtë programi, zëri ushqime. Efektet financiare janë llogaritur vetëm për pagën minimale. Paga minimale është nga klasa 1 deri në klasën 7, ka dalë një vendim tjetër i KM I cili ka dalë këto ditë 242 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM 234 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione administratës publike niveli i pagave nga 9 deri 13 kalon nga 40,000 deri në 46,700 që do të thotë shumë shpejt ekzekutivi do të vijë me një material tjetër për të llogaritur efektet financiare sipas këtyre klasave. Pra efektet financiare janë vetëm për pagën minimale.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka ndonjë pyetje? Nga komisioni? Për materialin numër 9

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për materialin numër 10



Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 11 e rendit të ditës.**

"PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 NË NIVEL PROGRAMI".

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Ekzekutivi V.Ziko: Për miratimin e tavanëve përgatitore të PBA 2024-2026 është mjaft i rëndësishëm sepse nga miratimi i tavanëve fillon dhe procesi i përgatitjes të kërkesave buxhetore për PBA 2024-2026. Tavanet përgatitore janë përgatitur duke iu referuar Udhëzimit standart 'Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore', si dhe të udhëzimit për vitin 2023 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026", duke iu referuar dhe ligjit ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", VKB nr. 1 datë 16.1.2023 "Për miratimin e kalendarit të PBA 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024, Bashkia Korçë", VKB nr. 13 datë 25.1.2023 "Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave". Vendosja e një tavanit të shpenzimeve do të kuptojmë kufirin e sipërm të shumës totale të parave që mund të shpenzohet dhe të planifikohen për tu shpenzuar për një qëllim të caktuar. Përgatitja e tavanëve është bërë mbi bazën e 11 programeve të cilat përfshijnë 27 funksione dhe këto programe janë:

Programi Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim

Programi Siguria Publike

Programi Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor

Programi Mbrojtja e Mjedisit

Programi Shërbime Publike Vendore

Programi Kultura, Sport dhe Argëtim

Programi Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor

Programi Arsimit Mesëm i Përgjithshëm

Programi Përkujdesi Social

Programi Fondi Rezervë

Programi Fondi i Kontigjencës

Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës janë planifikuar si më poshtë:

2024 20,000 mijë lekë

2025 20,000 mijë lekë

2026 20,000 mijë lekë

Burimet kryesore të financimit për përgatitjen tavanve janë të ardhurat nga taksat dhe tarfiat vendore, transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuar sektoriale. Duke iu referuar miratimit me VKB të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave, llogaritja e të ardhurave është bërë nga viti në vit duke iu referuar vitit 2023 rritja e tyre do të bëhet me nga 1%. Pra që do të thonë nëse në vitin 2023 planifikimi i të ardhurave është në vlerën 1,196,936 lekë për vitin 2024 1,204,663 lekë, për vitin 2025 me 1% në krahasim me vitin 2024 1,216,710 lekë dhe për vitin 2026 me vlerën 1,228,877 lekë. Pjesë përbërëse e burimeve të financimit janë edhe transfertat e pakushtëzuar transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme jepet si më poshtë:

2024 në vlerën 560,733 mijë lekë, me një rritje prej 28,671 mijë lekë krahasuar me vitin 2023 ose 5.4% .

2025 në vlerën 590,771 mijë lekë me një rritje prej 30,038 mijë lekë krahasuar me vitin 2024 ose 5.4%.

2026 në vlerën 621,708 mijë lekë me një rritje prej 30,937 mijë lekë krahasuar me vitin 2025 ose 5.2%.

Transfertat e pakushtëzuar sektoriale është tjetër burim financimi. Kjo do të përdoret për e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Konkretisht për personelin mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale .Transfertat e pakushtëzuar sektoriale do të jetë 1 përqind më e lartë për çdo vit buxhetor (në vitin 2024 do jetë 1% më e lartë se sa në 2023, në 2025 do të jetë 1% më e lartë se sa në 2024 dhe në vitin 2026 do të jetë 1% më e lartë se sa në vitin 2025). Janë llogaritur dhe tavanet ku janë të pasqyruara dhe në material, tavanet e përgatitjes së PBA ku theksojmë që shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore në krahasim me vitin 2023 do të kenë një rritje prej 10%, për vitin 2025 mund të kenë një rritje prej 2% me 2024 dhe me vitin 2026 do të kenë një rritje prej 2% krahasuar me vitin 2025. Theksojmë që në llogaritjen e tavanëve të paraqitur për miratim në KB nuk është marrë parasysh efekti i ndryshimit të pagave që do të thotë as efekti i pagës minimale dhe as i të gjitha ndryshimeve që do të ndodhin gjatë kësaj kohe. Dhe në miratimin e tavanëve që do të paraqiten mbas miratimit të PB të parë afatmesëm që do të miratohet në fund të qershorit, në korrik kur të paraqiten tavanet e reja do të merret parasysh edhe efekti i pagave. Ndërsa në shpenzimet korrente mesatarisht është marrë një rritje prej 1% por njëkohësisht në llogaritjen e shpenzimeve korrente dhe të shpenzimeve për investime pikë së pari janë marrë parasysh edhe kontratat afatgjatë që mund të jenë 2 vjeçarë ose 3 vjeçarë si dhe shërbimet publike ashtu dhe investimet.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

## **Pika 12 e rendit të ditës.**

" PËR DETAJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN CIVILE".

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Këshilltari M.Nene: Nga ekzekutivi është paraqitur relacioni përkatës për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile. Është paraqitur baza ligjore. Ky fond i kushtëzuar i miratuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 për Bashkinë Korçë është në shumën 20,523,803 lekë. Ky fond nuk trashëgohet në vitin pasardhës. Bazuar në VKM-në, nr, 414, datë, 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", nga ana e Bashkisë Korçë:nisur dhe nga kërkesat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Drejtorisë së MZSH-së, dhe NjA-ve,përmasat për parandalimin dhe menaxhimin e riskut në teritorin e Bashkisë, si dhe për kompletimin me pajisjet e nevojshme për realizimin e detyrës, fondin e akorduar është menduar që përdoret si mëposhtë. Tabela në vijim tregon të gjitha shpenzimet e parashikuara nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit. Është një tabelë analitike duke analizuar të gjitha zërat e shpenzimeve të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, sa është shuma e parashikuar në lek, shpenzime për blerje kripe për emergjencat civile dimërore, shpenzime për blerje e pajisjeve profesionale, shpenzimet për blerjen e karburantit. Është përcaktuar dhe baza ligjore se ku mbështeten këto të gjitha zërat e këtyre shpenzimeve, drejtoria se ku do të mbështeten ato dhe të gjitha zërat përkatëse. Në këto kushte bazuar në bazën ligjore që përmenda pak më lart kërkohet nga KB miratimi i fondit në vlerën që citova pak më lart sipas të gjithë zërave të shpenzimeve që ishin detajuar në mënyrë të qartë. Ftoj anëtarët e KB që ta miratojnë materialin.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka dicka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM

## **Pika 13 e rendit të ditës**

**(SIPAS KËRKESËS TË TREGU I SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA-PERIMEVE KORÇË SH.A, PËR THIRRJEN E ASAMBLSESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE ) PËR SHQYRTIMIN E MATERIALEVE SI MË POSHTË:**

- a - Pasqyrat financiare per treguesit e vitit 2022
- b -Raport auditimi i eksperteve kontabel per vitin 2022
- c -Plan Biznesi per vitin 2023

d -Propozimi per emerim te eksperteve kontabel te miratuar.

dh - Shperndarjen e Fitimit te vitit 2022 i cili do te kaloje per investime.

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kalojmë si Asamble e Përgjithshme e Shoqërisë Tregëtare Tregu i shitjes me shumicë i fruta perimeve në Korçë.

Drejtori i Shoqërisë: Analizat për të ardhurat financiare për vitin 2022 janë si më poshtë : të ardhurat 18,118,108 lekë janë realizuar të ardhurat për vitin 2022 në vlerën 17,013,779 lekë më pak se plani dhe krahasur me të njëjtën periudhë të vitit 2021 janë realizuar 739,647 lekë më pak. Të ardhurat nga magazinat janë planifikuar 5,849,742 lekë janë realizuar më pak 5,545,600 lekë pra 94% dhe krahasuar me të njëjtën periudhë nga viti i kaluar janë realizuar 94,104 lekë më pak. Kjo vlerë e të ardhurave të magazinave është kështu pasi është larguar një subjekt tregëtar që zhvillonte aktivitet brenda tregut. Qiratë e lokalit janë planifikuar në masën 1.329,600 lekë, janë realizuar në vlerën 1,329,600 lekë dmth 100%. Një zë tjetër i të ardhurave dhe shpenzimeve është edhe abonetë nga triciklat që futen brenda në treg, transportin e mallrave të tregëtarëve, këto të ardhura ishin planifikuar në masën 1,320,000 lekë dhe janë realizuar në masën 1,155,840 lekë pra 95%. Zë tjetër janë edhe vendparkimet të cilat janë realizuar me vlerën absolute 8900 lekë më pak se plani. Zë tjetër që ze një peshë të madhe në të ardhurat e tregut janë biletat e tregut. Zërat biletat e tregut kanë pasur rënie për arsye sepse kriza plus edhe sepse nuk kishim shumë vite që hymë brenda në treg, plus edhe fermerët që zhvillojnë aktivitetin që kanë taksë ditore, dhe kjo ka të bëjë me rënien të vlerës së planifikuar 873,579 lekë më pak. Ky zë ka ulje edhe në krahasim me vitin 2021. Shpenzimet në treg është zëri për shpenzime për energjinë elektrike edhe në konsumin e ujit të pijshëm. Në planifikimi është i planifikuar të gjitha shpenzimet, është konsumuar më tepër energji sec duhet, do të thotë që është realizuar në masën 111%. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e shtimit të subjekteve të reja por dhe me konsumin e energjisë nga magazinat e tjera. Gjithashtu janë bërë dhe kontrole të vazhdueshme edhe me parkimet dhe përmendet që nga ana e administratës kontrollat janë si gjatë ditëve të javës dhe gjatë ditëve të fundjavës. Pak a shumë këto janë të ardhurat dhe realizimet nga viti 2022. Përsëri këtë vit është menduar të bëhen investime me vlerën 70,000 lekë është menduar dhe një investim tjetër në banjat e tregut me vlerën prej 20,000 lekësh për riparimin e tyre. Është planifikuar për vitin 2023 të realizohen të ardhurat 17,982,000 lekë kemi bërë planifikim për vitin 2023, kemi bërë një rritje prej 2%. Zëri i shpenzimeve është për vitin 2022 janë realizuar 14,921,000 lekë dhe për këtë vit 15,550,000 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një pyetje kam unë, efekti i ndryshimit të pagave prej këtij muaji dhe për efekt të pagave minimale por dhe për efekt të asaj c'ka pritet të ndodhë me rritjen e pagave si është parashikuar? Keni bërë një parashikim, një analizë paraprake.

Drejtori i Shoqërisë: Përsa i përket rritjes së pagave kemi menduar që të rrisim vlerën e biletave të fermerëve që zhvillojnë aktivitet atje. Domethënë biletën që paguajnë fermerët që e kanë 100 lekë të vjetra për 1m mund ta zhvillojmë ta bëjmë me 150 lekë ose 200 lekë, plus edhe një rritje

të ardhurash të qirave të magazinave, megjithatë kjo është në diskutim e sipër, sepse ndryshe nuk kemi ku ti rrisim të ardhurat. Jemi munduar me të gjitha vështirësitë e krijuara sepse ka pasur një rënie cdo vit, edhe këtë vit përsëri vazhdon me rënietë ardhurash thjesht nga biletat e tregut. Ka dy muaj që fermerët nuk po vijnë fare të zhvillojnë aktivitet plus dhe nga mjetet që vijnë furnizojnë ka një rënie. Në këto moment mund të marrim një mesatare ditore rënie 400-500 lekë në muaj. Kjo për tregun është shumë lekë, sepse të ardhurat e tregut janë minimale me këto cmime që janë dhe subjektet janë shumë pak. Pjesa dërmuese e magazinave nuk japin aktivitet të plotë. Jemi munduar me të gjitha subjektet që zhvillojnë aktivitet jashtë ju kemi dhënë magazinat brenda.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra kapacitet për të rritur të ardhurat ka.

Drejtori i Shoqërisë: Mendoj që do bëjmë çfarë është e mundur që tregun ta nxjerrim me fitim përsëri pavarësisht këto problemet që na ndodhen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka ndonjë pyetje? Janë 5 pika. Pasqyrat financiare per treguesit e vitit 2022, Raport auditimi i eksperteve kontabel per vitin 2022, Plan Biznesi per vitin 2023, Propozimi per emerim te eksperteve kontabel te miratuar, Shperndarjen e Fitimit te vitit 2022 i cili do te kaloje per investime. Për propozimet e emrave të përgatitet grupi i majtë i partisë socialiste për emrat. Ndërkohë për pikat e tjera ka pyetje?

Këshilltare A.Verushi: Propozimi i emrave të ekspertëve kontabël Vasil Xega dhe Ilda Ikonomi.

Hidhet në votim dhe miratohet **Pasqyrat financiare per treguesit e vitit 2022**

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Hidhet në votim dhe miratohet **Raport auditimi i eksperteve kontabel per vitin 2022**

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Hidhet në votim dhe miratohet **Plan Biznesi per vitin 2023**

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Hidhet në votim dhe miratohet **Propozimi per emerim te eksperteve kontabel te miratuar,**

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Hidhet në votim dhe miratohet **Shperndarjen e Fitimit te vitit 2022 i cili do te kaloje per investime**

Vota PRO 31

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 14 e rendit të ditës.**

(SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË KORÇA 2008 SH.A, PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE ) PËR SHQYRTIMIN E MATERIALEVE SI MË POSHTË:

a -Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2022 të Shoqërisë Korça 2008 sh.a

b - Për shperndarjen e fitimit te vitit 2022 të Shoqërisë Korça 2008 sh.a

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kalojmë si asamble e përgjithshme e pronarit për shoqërinë Korça 2008.

Drejtori i shoqërisë: Si këshilli mbikqyrës kemi marrë dy vendime sipas ligjit përkatës njëri është miratim i pasqyrave financiare dhe tjetri është shpërndarja e fitimit që është me vlerën 1,126,000 lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ndonjë informacion për këshillin shkurt.

Drejtori i shoqërisë: Jo nuk kemi ndryshime.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Detyrimet i keni vazhduar i keni shlyer.

Drejtori i shoqërisë: Po shlyejmë detyrimet e prapambetura.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga komisioni ka diçka? Nga këshilltarët? Nga anëtarët e trupës së aksionerëve.

Hidhet në votim dhe miratohet **Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2022 të Shoqërisë Korça 2008 sh.a**

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Hidhet në votim dhe miratohet **Për shperndarjen e fitimit te vitit 2022 të Shoqërisë Korça 2008** sh.a

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 15 e rendit të ditës.**

INFORMACION; KËSHILLI RINOR , ROLI I TYRE NË VËNDIMARRJEN E KËSHILLIT BASHKIAK .

Sekretare E.Naçi: Ky është një material të cilin ne e kemi parashikuar në planin e aktiviteteve të këshillit dhe mund të relatojë Johani.

Këshilltar J.Deli: Këshilli vendor rinor është një organ këshillimor pranë kryetarit të bashkisë. Është miratuar me VKB datë 29.07.2022 nr 122 dhe ky këshill është i përbër nga 10 antarë ku kryetari i këshillit është kryetari i bashkisë anëtarët e tjerë janë përfaqësues nga organizatat që merren me të rinjtë në qytetin tonë po ashtu edhe nga këshilli studentor i universiteti F.S.N po ashtu edhe nga qeveritë e nxënësve të gjimnazeve të qytetit. Detyra e këtij këshilli janë :

Promovimi i projekteve dhe i iniciativave të ndryshme që zhvillojnë në qytet për të rinjtë.

Këshillon njësitë e vetqeverisjes vendore për politikat e ndryshme që ndiqen dhe hartohen në bashkinë Korçë.

Vlerëson situatën dhe zbatimin e planeve për të rinjtë.

Nxit takime dhe propozon përmirësime të politika të ndryshme në këtë qytet. Bashkia Korçë ka planin lokal të veprimit për vitin 2022-2023, po ashtu tani dhe me miratimin e strategjisë kombëtare të rinisë për 2022-2029 besoj që puna e Këshillit Vendor Rinor do të jetë për përpilimin e një plani të ri për të rinjtë për vitet në vijim.

Këshilltare E.Menkshi: U punësuan ata të rinjtë apo dicka?

Ekzekutivi A.Dishnica: Vetëm një pjesë janë punësuar. Nuk janë zënë të gjitha pozicionet, janë zënë 5 pozicione .

Këshilltare E.Menkshi: Kishte kandidatura?

Ekzekutivi A.Dishnica: Po kishte.

### **Pika 16 e rendit të ditës.**

## INFORMACION N.SH.M.A.Ç (MATERIALE JASHTË PËRDORIMIT).

Përfaqësuese nga N SH M A C: Materiali është një informacion që I drejtohet këshillit për materialet që dalin jashtë përdorimit të cilat janë pjesë e inventarëve të Institucioneve Arsimore . Mbështetur në ligjin Nr 139/2015 “ Për vetqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr 10296 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të ndryshuar , Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr 30 dt 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe ndryshimet e tij , VKB Korçë Nr 70 Dt 29.06.2018 “Rregullore për menaxhimin e aktiveve dhe menaxhimin e riskut të aktiveve të Bashkisë Korçë” NSHMAC kryen procedurën e inventarizimit vjetor të aktiveve në varësi të saj. Janë dy komisione përkatëse dhe komisioni i vlerësimit dhe i asgjësimit. Komisioni i vlerësimit duke marrë në bazë të gjitha specifikat e materialeve të këtyre institucioneve hartoi listat përkatëse për ato material të cilat ishin dhe të vjetëruara, të dëmtuara dhe të amortizuara. Specifikat janë në listat e dëmtuara dhe thekson që këto materiale nuk janë më të përdorshme. Gjithashtu këto material ngaqë ishin dëmtuar nuk ishin më të përdorshme për vazhdimin e aktivitetit. Automatikisht ato propozohen për dalje jashtë përdorimit. Komisionet e asgjësimit të cilat do të bëjnë asgjësimin e këtyre materialeve të cilat një pjesë do të groposen dhe një pjesë do të përdoren si lëndë drusore për ngrohjen e shkollave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje?

### **Pika 17 e rendit të ditës.**

## INFORMACION NË LIDHJE ME INVENTARIZIMIN E AKTEVE AFATGJATA , AFATSHKURTRA DHE MATERIALE TË BASHKISË KORÇË SI DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2022.

Ekzekutivi V.Ziko: Ky është një informacion pothuaj identik N.SH.M.A.C ku inventarizimi kryhet 1 herë në vit nga bashkia bashkë me njësite administrative në zbatim të ligjit 139 “ Për vetqeverisjen vendore” ligji 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe udhëzimi nr.30 të ministrisë së financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public. Duke iu referuar pra të gjitha këtyre që përmenda më sipër janë urdhrat e kryetarit si për inventarizimin e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra janë kryer të gjitha procedurat me urdhër të kryetarit përsëri vlerësimi I aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra dhe përsëri me urdhër të kryetarit është ngritur komisioni për asgjësimin. Në inventarizimin e kryer nga bashkia për vitin 2022 komisioni ka arritur në konkluzionin që vlera prej 2,877,754 lekë është për asgjësimin i cili është kryer me urdhër të kryetarit të bashkisë pranë komisionit përkatës dhe vlera prej 722,526 është për riciklim. Ekzekutivi ka dërguar të gjithë këtë materialin sipas procesverbaleve të mbajtura nga komisionet përkatëse për të kryer vlerësimin për aktivet të cilat janë në riciklim dhe mbas vlerësimit të kryer nga punonjësit të cilët janë ngarkuar me këtë qëllim I gjithë materiali do ti kalojë drejtorisë së përgjithshme juridike dhe të personelit për të vazhduar procedurat e mëtejshme për zhvillimin e procedurave të ankandit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje?



## **Pika 19 e rendit të ditës.**

### **KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE**

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve janë trajtuar dhe nuk janë neglizhuar asnjëherë. Referuar këtij këshilli ankesat apo kërkesat e qytetarëve kanë kaluar për zgjidhje në ekzekutivi. E cilësova pak meqënëse kjo është mbledhja e fundit. Unë po jap disa vlerësime personale si mbledhja e fundit. Duke ju falenderuar të gjithëve, për bashkëpunimin që kemi pasur në funksion të këshillit, duke i analizuar materialet. Partitë e vogla kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, por kuptohet mungesa e opozitës në sallë nga dëshira e tyre jo nga pamundësia. I lanë vendet bosh për 4 vjet. Shpresoj që në vitet në vijim të jenë present duke punuar dhe kontribuar dhe duke marrë mandatet. Është një kërkesë drejtuar KB, Unë e nënshkruar nga Adelina Shatro kërkoj një banesë, jam nënë e 7 fëmijëve ka shkruar dhe diçka për djalin e vogël nuk po i lexoj emrin për ti ruajtur privatësinë. Nuk e di është një rast që njihet ?

Ekzekutivi M.Balli: Po është një rast që njihet , madje ka bërë njëherë një deklaratë që nuk ka përfituar sepse ato mundësi . Tani qytetarja ka pretendime dhe në mundësinë e parë që do kemi edhe me plotësimin e kriterëve ta trajtojmë. Nuk jeton në një dhomë, ambienti është me 2 dhoma. Gjithmonë në plotësim të kushteve do të përpiqemi ta trajtojmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani rastin e njohim dhe përgjigje i kemi kthyer. Pavarsisht se familja është e madhe dhe I takon më tepër sipërfaqe në dakordësi me zonjën aplikuese është gjetur një zgjidhje momentale për ta strehuar tek apartamenti që ne kishim në dispozicion dhe që ajo e ka pranuar në momentin e parë, por biem dakord të dy palët që nuk është kjo zgjidhja përfundimtare dhe ne me të patur një opsion për një apartament me sipërfaqe më të madhe do tja vemë në dispozicion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Është një material tjetër, sot e mora si material. Kam përshtypjen që është nevoja për një sqarim juridik, nuk është kompetencë e KB.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dëshiroj të falenderoj gjithësecilin prej jush këshilltarët qofshin të partisë socialiste qofshin të partive të tjera më të vogla të cilat fituan një mandat për të qënë pjesë e KB në katër vitet që përmbyllen me mbledhjen e sotme dhe e ushtruan këtë detyrë dhe këtë funksion i cili është një përgjegjësi përveç të tjerave edhe një përgjegjësi civile në raport me komunitetin, votuesit dhe me zgjedhësit. Besoj se të gjithë sëbashku edhe KB edhe administrata e bashkisë kemi bërë një punë të mirë dhe kemi patur vendimarrje shumë të rëndësishme të cilat pastaj ju kanë hapur rrugë shumë projekteve me përfitues segmente të ndryshme të komunitetit, qoftë në qytetin e Korçës qoftë në fshatrat e bashkisë së Korçës.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**  
**ERJON NEXHIPI**